

*The District District of Philadelphia*  
Watson T. Comly Elementary School  
1001 Byberry Road  
Philadelphia, PA 19116

Kate Sylvester, Drejtore  
ksylvester@philasd.org

Telefoni: (215) 400-3010  
Faksi: (215) 400-3011

---

*Studentët e shkolles Comly do të jenë të fuqizuar, mendimtarë kritikë që bëjnë një ndikim pozitiv në botë.*

3 Gusht, 2021

Të dashur familjet e Comly:

Shpresoj që të keni kaluar një verë të mirë deri tani! Ne jemi të gëzuar për kthimin në mësimin në-person këtë vit! Unë do të doja të prezantoja anëtarët tanë të rinj të personelit, Znj. Olivia Rosenfeld (Këshilltare), Znj. Madison Toner (Mësuese e Klasës së 1) dhe Znj. Stephanie Ryan (Mësuese e Mbështetjes Autistike). Mirësevini në ekipin Comly! Ndërsa po afrohem 31 Gushtit-dita e parë e shkollës-doja të kontaktoja me disa informacione të rëndësishme.

#### Class Dojo

Ju lutemi sigurohuni që njoftimet tuaja të jenë të aktivizuara në Class Dojo. Ky do të jetë burimi ynë kryesor i komunikimit këtë vit. Do të dërgoj shumë informacione gjatë javëve të ardhshme për t'u përgatitur për fillimin e shkollës. Vini re, personeli ynë do të kthehet më 23 Gusht 2021, kështu që ju nuk do të dëgjoni nga mësuesi i fëmijës tuaj para kësaj date. Nëse keni pyetje, ju lutemi kontrolloni “School Story” për të parë nëse ato janë adresuar. Nëse keni akoma pyetje pasi keni kontrolluar postimet e “School Story” ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni përmes mesazheve në Class Dojo.

#### Detyrat e klasës për 2021- 2022

Detyrat e klasës së fëmijës suaj do të jenë të disponueshme në javët e ardhshme në Portalin e Prindërve. Unë do të ndaj me ju datën e saktë sapo ta kem marrë nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias. Shkolla Comly do të fillojë riorganizimin e klasave të Class Dojo gjatë javës së 16 Gushtit. Ju do të jeni në gjendje të shihni se kush është mësuesi i fëmijës tuaj pasi të bëhen këto ndryshime.

#### Orari i Shkollës

Siç e ndava me ju në fillim të kësaj vere, Drejtoria Arsimore e Filadelfias dhe personeli këtu në Comly janë të përkushtuar të bëjnë gjithçka që mundemi për të përshpejtuar rezultatet e studentëve pas 18 muajsh mësimi nga shtëpia dhe hibrid, dhe shumë pasiguri si qyteti ynë dhe kombi u përball me pandeminë. Pjesë e strategjisë së madhe për përmirësimin e rezultateve për të gjithë studentët, është zbatimi i një qasjeje të standardizuar për kohën e fillimit dhe mbarimit të përditshëm.

*The District District of Philadelphia*  
Watson T. Comly Elementary School  
1001 Byberry Road  
Philadelphia, PA 19116

Kate Sylvester, Drejtore  
ksylvester@philasd.org

Telefoni: (215) 400-3010  
Faksi: (215) 400-3011

---

*Studentët e shkollës Comly do të jenë të fuqizuar, mendimtarë kritikë që bëjnë një ndikim pozitiv në botë.*

Standardizimi i kohës sonë të shkollës do të ndihmojë në pakësimin e kohës që studentët humbasin në autobuza, do të ndihmojë në sigurimin e autobuzave në kohë më shpesh, do të lejojë pastrimin e vazhdueshëm të zonave që preken më shumë në autobuza dhe do të ndihmojë Zyrën e

Shërbimeve të Transportit të kapërcejë një ulje të konsiderueshme në personelit për shkak të largimit dhe daljes në pension gjatë 18 muajve të fundit.

**Si rezultat, Comly ka kohë të reja fillimi dhe mbarimi për Vitin Shkollor 2021-2022. Këtë vit, shkolla do të fillojë në 8:15 të mëngjesit dhe do të përfundojë në 2:54 pasdite çdo ditë.** Ne po ndajmë këtë kujtesë në mënyrë që nëse nuk e keni bërë tashmë, mund të filloni të bëni ndonjë përgatitje të nevojshme familjare para kohe për të siguruar që fëmija juaj të mund të ndjekë shkollën në kohë çdo ditë në përputhje me këtë orar të ri.

#### Kalendari Shkollor i Filadelfias

Shikoni kalendarin akademik 2021-2022 këtu: <https://www.philasd.org/calendar/>

#### Kopshti

Një tjetër rregullim që po bëjmë në orarin e këtij viti është ai për nxënësit e Kopshtit. Pesë ditët e para të shkollës - 31 Gusht, 1 Shtator, 2 Shtator, 3 Shtator dhe 8 Shtator - do të jenë gjysmë dite, me nxënësit që bëjnë mësim vetëm në mëngjes. Ky kalim më i ngadalshëm në mësimin ditor do t'i japë nxënësve tanë më të vegjël kohën që u nevojitet për t'u përshtatur me rutinat normale të shkollës. Përveç kësaj mësuesit tanë të kopshtit do të jenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në trajnimin profesional dhe të ndihmojnë me intervistat familjare gjatë asaj jave të parë. Nëse keni nevojë për mbështetje shtesë për kujdesin e fëmijëve për ato pesë ditët e para, jeni të inkurajuar të kontaktoni kujdestarin e fëmijës suaj, vizitoni faqen e internetit të Qendrës së Burimeve të Mësimin të Hershëm të Filadelfias/ Philadelphia's Early Learning Resource Center në [philadelphiaelrc18.org](http://philadelphiaelrc18.org) ose telefononi 1-888-461-KIDS (5437).

#### Uniformat

Jemi të gëzuar të njoftojmë se kemi fituar një grant nga Neubauer Family Foundation për të krijuar një logo dhe bluzë të re për uniformat e shkollës sonë. Ne do të vazhdojmë të kemi pjesën e sipërme të verdhë dhe fundet blu, por në një moment të vitit shkollor do të prezantojmë edhe bluza të reja me ngjyrë blu. Ne nuk duam që ju të duhet të investoni shumë në pjesën e sipërme të verdhë kështu që këtu kemi çfarë lejohet për fillimin e vitit:

*The District District of Philadelphia*  
Watson T. Comly Elementary School  
1001 Byberry Road  
Philadelphia, PA 19116

Kate Sylvester, Drejtore  
ksylvester@philasd.org

Telefoni: (215) 400-3010  
Faksi: (215) 400-3011

---

*Studentët e shkolles Comly do të jenë të fuqizuar, mendimtarë kritikë që bëjnë një ndikim pozitiv në botë.*

- \*Pjesa e sipërme me ngjyrë të verdhë të lehtë
  - \*Pjesa e sipërme ngjyrë blu (bluza të thjeshta ngjyrë blu janë të mira)
  - \*Bluzë blu për fiskulturë (çdo ditë të javës, jo vetëm ditën e fiskulturës)
  - \*Pjesa e poshtëme, ngjyrë blu
- Bluzat për fiskulturë do të shiten kur të fillojë viti shkollor.

#### Listat e Materialeve

Ju lutemi klikoni në lidhjen më poshtë për të hyrë në listat e materialeve sipas klasës.

[https://docs.google.com/document/d/1rQPFplrqi\\_Z33PcS-H6KICcAdD9PIP\\_EcoFPIkT0yMQ/edit?usp=sharing](https://docs.google.com/document/d/1rQPFplrqi_Z33PcS-H6KICcAdD9PIP_EcoFPIkT0yMQ/edit?usp=sharing)

#### Fjalëkalimi / Password për studentët

Passwordet e reja për studentët K-5 do të caktohen të Hënën, më 23 Gusht, 2021. Ne do ti japim passwordet e reja kur nxënësit të kthehen në shkollë. Mos u shqetësoni nëse studentët nuk mund të hyjnë në portalin e tyre.

Më shumë informacion në lidhje me kthimin tonë në shkollë në vjeshtë dhe mundësitë për të marrë pjesë në takime dhe ngjarje të nivelit shkollor dhe të Drejtorisë do të ndahen me ju gjatë fushatës së Drejtorisë “Back to School” nga 31 Gushti-dita e parë e shkollës. Ndërkohë, ju inkurajoj që të vizitoni rregullisht faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për informacione më të reja mbi kthimin tonë në mësimin e plotë, në-person: [www.philasd.org/ringthebell](http://www.philasd.org/ringthebell). Unë do të vazhdoj të ndaj me ju informacione të nivelit shkollor gjithashtu.

Kalofshi gëzuar pjesën tjetër të verës. Mezi pres të mirëpres fëmijët tuaj përsëri në shkollë më 31 Gusht!

Sinqerisht,

Kate Sylvester